



Pranimar / Bortorio Prilpuno / Predato Recevea / Delivety	23.06.2021	1	viti god year
Organi / Njesia Organi / Jednina Org / Unit	In. Prad In. Prad Prad No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPNSHICK	3284/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS

A.nr.411/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 411/2021 të datës 11.05.2021 të parashtruar nga grup ankuesish dhe të cilat me autorizim i përfaqëson avokat

kundër organit të punësimit Komuna e Shtimes, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.411/2021 e datës 11.05.2021, e parashtruar nga grup ankuesish të cilët me autorizim i përfaqëson Avokati

A r s y e t i m

Ankuesit dhe nëpërmjet përfaqësuesit të tyre me autorizim, më datë 11.05.2021 kanë parashtruar ankesë me numër protokoll 2331/2021 të regjistruar A.nr.411/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Komunës së Shtimes, për mos veprim për pagës të pagave jubilarë dhe shujtës ditore për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018, sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.05.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Komuna e Shtimes. Ndërsa Këshilli me datë 26.05.2021, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Shtimes, se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 411/2021 të datës 11.05.2021 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Autorizimin e datës 22.03.2021, nga 22.03.2021, nga për avokatin për avokatin Autorizimin e datës 12.03.2021; Kërkesën e datës 06.04.2021, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes, Listë e Pagave për 31.12.2018, Vërtetimin e datës 01.03.2021, për nr.02/Nr.79, Shkresë Emërimi i datës 24.01.2011 për periudhën 01.12.2019 deri 31.12.2019; Vërtetimin e datës 01.03.2021 Nr.02/1.Nr.38 , për Vërtetimin 02/11.Nr.39 e datës 23.02.2021, Ndryshimin dhe Plotësimi i datës 15.03.2019; Listën e pagave për 02/L/Nr.53 të datës 23.02.2021 për për periudhën 01.12.2018 deri 31.12.2018, Vërtetimin me numër 02/L/Nr.53 të datës 23.02.2021 për vërtetimin më numër 02/1.Nr.54 të datës 23.02.201 për Sylejman Xhelili, Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit të datës 09.07.2013; Përgjigje në ankesë e datës 26.05.2021, Përmirësimi në aktin administrativ të datës 24.05.2021; e-mailin e datës 24.05.2021 fq.1.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesve është e pa bazuar, *sepse*:

Bazuar në shkresat e lëndës, është konstatuar se të gjithë ankuesit janë të punësuar në Komunën e Shtimes.

Ankuesit më datë 06.04.2021, kanë parashtruar kërkesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Shtime, për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtës ditore për ditët e pranisë në punë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive për periudhën nga 01.01.2015 deri 31.12.2018. Ndërsa në përgjigje të kërkesës, Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Ankesave për Nëpunësit Publikë, me atë 28.04.2021, ka njoftuar përfaqësuesin e autorizuar të ankuesve se sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësit civil paraqesin ankesë drejtpërdrejtë në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil.

Pas këtij njoftimi, ankuesit, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 11.05.2021 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtave ditore, për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018, sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo më shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.

Bazuar në këtë konstatim, dhe në kuptim të nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, Kolegji konstaton se kërkesa e ankuesve për realizimin e kompensimit të pagave jubilarë dhe shujtave ditore për vitin 2015, 2016, dhe 2017 është parashkruar, kështu që pretendimi ankimor i ankuesve mbi këtë bazë ligjore është i pa bazuar.



Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nën 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda Nr. A. Nr. 411/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ - DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueseve avokatit
- Kryetarit të Komunës së Shtimes;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Shtimes;
- Arkivit të KPMSHCK-së

